



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 26 Prill 2021

Nr: 322

V E N D I M

P Ë R

**SHFUQIZIMIN E TË GJITHË VENDIMEVE PËR AKREDITIM TË VËZHguesVE NË
VENDIN E NUMËRIMIT TË VOTAVE NË KZAZ NR.30, QARKU TIRANË**

Në mbështetje të neneve 19, pika 1, shkronjat “b” e “n”, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të neneve 108, 113 e 116 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Shfuqizimin e të gjithë vendimeve për akreditim të vëzhguesve në vendin e numërimit të votave në KZAZ nr.30, qarku Tiranë dhe shpalljen e tyre si akt administrativ absolutisht i pavlefshëm.
2. KZAZ nr. 30, qarku Tiranë, do të pranojë vetëm ata vëzhgues të akredituar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, nga data 26 Prill 2021, ora 22.00 e në vazhdim.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

